



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 49, Datë 24.03.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” SH.P.K., NR. 286, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 59, DATË 23.04.2015.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma d) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma e); nenit 5, pika 1, gërma e); nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 24.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 432 Prot., datë 13.02.2020, mbërritur në drejtori në datën 20.02.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 25.09.2014, është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42125016S.
- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet : Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Konstatohet se shoqëria “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Format i dhe dokumentacioni për aplikimet (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo jo të plotë, që ka të bëjë me:

### **Neni 9, pika 2**

#### **Dokumentat juridike, administrative dhe pronësor.**

- **gërma “c”** (Vërtetimi i rregjistrimit dhe ekstrakt historik nga QKB).
  - Do ti kërkohej shoqërisë ta plotësojë Vërtetimin e regjistrimit pranë QKB-së, në zbatim të kësaj kërkesë të rregullores.
- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
  - Do ti kërkohej shoqërisë të depozitojë në ERE Vërtetimet Gjykatës dhe Prokurorisë për administratorin e shoqërisë dhe përfaqësuesin e saj ligjor jo me vonë se 30 ditë nga përfundimi i gjëndjes së epidemisë së shkatuar nga Covid 19. në formën e kërkuar nga ligji.

### **Neni 16, pika 1, gërma “c”**

#### **Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3**

##### **Neni 9, pika 3**

- **gërma “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime).
  - Në vijim do ti kërkohej shoqërisë të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore.

#### **Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike**

##### **Neni 9, pika 4.8**

- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie).
  - Në vijim do ti kërkohej shoqërisë të bëjë me dije ERE-n, lidhur me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

*Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Energjisë Elektrike”, e ndryshuar, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.*

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë, NR. 286, Seria T15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 59, datë 23.04.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.04.2020.
2. Subjekti aplikues ka detyrimin për të paraqitur jo më vonë se një muaj nga perfundimi i epidemise Covid 19 vertetimet e percaktuara në nenin 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 215/2019.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**